

UDHËZIM I PËRBASHKËT
Nr. 33, datë 10. 9.2015

PËR NJË SHITESË NË UDHËZIMIN E PËRBASHKËT NR. 51, DATË 20.9.2013
“PËR PROCEDURAT E PËRDORIMIT TË FONDEVE TË BUXHETIT TË
SHTETIT PËR BOTIMIN, SHTYPJEN, SHPËRNDARJEN DHE SHITJEN E
TEKSTEVE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ligjit nr. 160/2014 “Për buxhetin e vitit 2015”, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 107, datë 10.2.2010, “Për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore, të sistemit arsimor parauniversitar”, të ndryshuar, të vendimit nr. 843, datë 2.11.2012 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e shtëpisë botuese të teksteve mësimore “BOTEM””, të ndryshuar, si dhe të vendimit nr. 9, datë 4.1.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e çmimit të teksteve shkollore për nxënësit e shkollave të arsimit profesional, nxënësit e pakicave kombëtare dhe nxënësit shqiptarë që jetojnë e arsimohen në diasporë”,

UDHËZOJNË:

1. Në udhëzimin e përbashkët nr. 51, datë 20.9.2013, “Për procedurat e përdorimit të fondeve të buxhetit të shtetit për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve të arsimit parauniversitar”, bëhet shtesa e mëposhtme:

1. Në sesionin III “Procedurat e përdorimit të fondeve buxhetore, për tekste shkollore të arsimit bazë, arsimit të mesëm të përgjithshëm dhe arsimit të mesëm profesional”, në fund të pikës 2, shtohen fjalitë me këtë përmbajtje:

“Në fund të çdo dite, botuesi regjistron tek pajisja fiskale të gjithë transaksionet e evidentuara në bazë të faturave tatimore të shitjes sipas formularëve E-TBV 055/A dhe formularit E-TVS 055/a. Këto transaksione duhet të jenë pjesë e raportit tatimor ditor të pajisjes fiskale që shërben për të kryer mbylljen ditore të aktivitetit të botuesit”.”

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT
Lindita Nikolla

MINISTRI I FINANCAVE
Shkëlqim Cani